



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI**

P R O J E K T L I G J

Nr.____ / 2026

PËR

DISA NDRYSHIME DHE SHTESA NË LIGJIN NR. 10 093, DATË 9.3.2009,
“PËR ORGANIZIMIN DHE FUNKSIONIMIN E AGJENCISË PËR
MBËSHTETJEN E SHOQËRISË CIVILE”

Në mbështetje të neneve 78 dhe 83, pika 1, të Kushtetutës, me propozimin e Këshillit të Ministrave, Kuvendi i Republikës së Shqipërisë

V E N D O S I:

Në ligjin nr.10 093, datë 9.3.2009, “Për organizimin dhe funksionimin e Agjencisë për Mbështetjen e Shoqërisë Civile”, bëhen këto ndryshime dhe shtesa:

Neni 1

Pika 4 e nenit 2, ndryshohet si më poshtë vijon:

“4. Statuti i AMSHC-së miratohet nga Këshilli i Ministrave dhe propozimet për të përcaktohen me vendim të bordit mbikëqyrës, i cili vendimin e përcjell nëpërmjet sekretarit të përgjithshëm të ministrisë përgjegjëse për mirëqënien sociale.”.

Neni 2

Në nenin 8, fjalia e dytë e pikës 4, ndryshohet si më poshtë vijon:

“Organizatat e shoqërisë civile, të regjistruara sipas ligjit, kanë të drejtë t’i dërgojnë propozimet për përfaqësim në bordin mbikëqyrës, pranë sekretarit të përgjithshëm të ministrisë përgjegjëse për mirëqënien sociale.”.

Neni 3

Në nenin 9, bëhen këto ndryshime:

1. Shkronja “f” shfuqizohet.
2. Në shkronjën “g” pas togëfjalëshit “ ... për veprimtarinë e AMSHC-së ...” shtohet “nëpërmjet sekretarit të përgjithshëm të ministrisë përgjegjëse për mirëqënien sociale.”.

Neni 4

Pika 4 e nenit 12 shfuqizohet.

Neni 5

Në nenin 13, bëhen këto ndryshime:

1. Pika 3 shfuqizohet.
2. Në pikën 4, hiqen fjalët “ ... ose i drejtorit ekzekutiv ...”.

Neni 6

Pika 3 e nenit 15 ndryshohet si më poshtë vijon:

“3. Nivelet e pagave dhe të shpërblimit të punonjësve të AMSHC-së, si dhe të

kryetarit e anëtarëve të bordit mbikëqyrës miratohen nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me legjislacionin e posaçëm në fuqi. Marrëdhëniet e punës së punonjësve të AMSHC-së rregullohen sipas parashikimeve të legjislacionit për nëpunësin civil. Marrëdhëniet e punës për punonjësit administrativë rregullohen sipas dispozitave të Kodit të Punës.

Neni 7

Në nenin 26, pas paragrafit të parë, shtohet një paragraf me këtë përmbajtje:

“Vendimi i bordit mbikëqyrës për miratimin e dhënies së grantit ankimohet në gjykatën administrative kompetente sipas legjislacionit në fuqi për gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative.”.

Neni 8

Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në “Fletoren zyrtare”.

K R Y E T A R I

NIKO PELESHI